

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTERISE TIRANE

NOTERE VIOLETA SULKAJ

NR 2100 REP

NR 1172 KOL



KONTRATE PER NDRYSHIMIN E STATUTIT TE

SHOQERISE TREGTARE

“NDERTUESI NR 1 ” shpk

FORMIMI

Neni 1

Sot ne Tirane ne daten 30. **05.2011** perpara meje noteres Violeta Sulkaj , Anetare e Dhomes se Noterise Tirane ndryshohet statuti i Shoqerise Tregtare me emertimin “**NDERTUESI NR 1**” shpk si shoqeri me pergjegjesi e kufizuar e ortakut dhe Administratorit te vetem:

Miltiadh Baballeku i biri i **Llambit** ,me datelindje **31 maj 1959i** lindur ne **Beratg** dhe banues ne **Tirane** ne rrugen e **Durresit** pallati **Konfort Tirane** dhe mbajtes i leter njoftim it elektronik me nr **027588073**

BAZA LIGJORE: L I G J I Nr. 9901, datë 14.4.2008 “ PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE” , Ligji Per Q.K.R. ne

SELIA

Neni 2

Selia e Shoqerise Tregtare “**NDERTUESI NR 1**” shpk eshte ne **Berat** lagja **28 nentori** . Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise si dhe jashte saj. Per kete ajo mund te hape edhe seli te tjera operative, filiale, perfaqesi dhe agjenci ne te gjithe territorin e R.SH., si dhe jashte saj, ne perputhje me ligjet e vendeve ku ato hapen.

KOHEZGJATJA

Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike e Shoqerise Tregtare "**NDERTUESI NR 1**" **shpk** është e pakufizuar. Ajo mund te shperbehet ne cdo moment, sipas vendimeve te marra nga Asambleja e Ortakeve.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 4

1. Prodhim I pjeseve te gatshme per ndertim si dhe ndertimi I objekteve ,banesave ,lokaleve si dhe transportimi l lendeve te para,tregtimi I tyre Brenda dhe jashte vendit .Tregtimi l artikujve te ndryshem industriale(elektrike,elektroshtepiujake,hidrosanitare ,konfeksione etj me shumice e pakice,import eksport ,tregtim te artikujve ushqimore e blegtorale

Shoqëria me qëllim të arritjes së objektivave shoqërore mund të marrë përsipër si direkt ashtu edhe indirekt, pjesmarrje në fitime e pjesmarrje në shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja që kanë objekt analog ose të lidhur me të tyren.

-Shoqeria kryen çdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektit te saj, duke perfshire edhe pjesmarrje ne kuota dhe aksione ne shoqeri dhe ndermarrje te tjera.

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKUT

Neni 5

Ortaku ka keto te drejta kryesore:

- te administrojne aktivitetin e shoqerise ne perputhje me Statutin e ndryshuar dhe Aktin Themelues;
- te marrin pjese ne fitimet e cfaredo forme e sasio te aktivitetit te Shoqerise, te parashikuara nga Akti themelues e Statuti i Shoqerise i ndryshuar ;
- te marrin ne cdo moment dokumente, si raporti i administrimit, inventare e llogari vjetore, per tre vitet e fundit financiar.
- te terhiqet nga Shoqeria, duke ia ofruar kuoten e vet me perparesi ortakeve te tjere te shoqerise. Ne mungese te ushtrimit te se drejtes se parablerjes nga ana e ortakeve te tjere, kuota mund t'iu kaloje te treteve, sipas kushteve e afateve ne parashikuara ne nenin 7 te Aktit Themelues dhe ne nenin 9 te ketij Statuti.

Neni 6

Ortaku ka keto detyrime kryesore:

- te depozitojne kuoten e tyre fillestare te nevojshme si dhe ato suplementare, ne perputhje me Statutin e ndryshuar dhe Aktin Themelues;



- te marrin pjese ne administrimin e Shoqerise nepermjet organeve te krijuara nga ata vete;
- t'i japin Shoqerise te dhenat e nevojshme per arritjen e te gjitha objektivave te genesishme per aktivitetin e saj;
- te permbushin te gjitha detyrat per realizimin e objektivave dhe funksioneve te shoqerise.

Neni 7

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, seline, objektin e shoqerise, kapitalin, kohezgjatjen etj, sipas vendimeve te marra nga vete ortaket ne mbledhjen e Asamblese.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 8

Kapitali themeltar i Shoqerise Tregtare **"NDERTUESI NR 1" shpk** eshte prej 9.000.000,00 leke i formuar nga Kapitalit themeltar i Ortakut dhe Administratorit te vetem te shoqerise , duke qene vlera nominale 1.000 00 dhe me nr pjesh 9.000,00

Neni 9

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie. Ato jane lirisht te transferueshme edhe ne rast ndarjeje pasurore mes bashkeshorteve. Gjithashtu jane lirisht te transferueshme ndermjet bashkeshorteve, si dhe ndermjet paraardhesve e pasardhesve.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve.

Pjeset e kapitalit themeltar mund t'iu transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne Shoqeri, vetem me miratimin e shumices se ortakeve qe perfaqsojne te pakten 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar.

Projekti i transferimit i njoftohet Shoqerise dhe secilit prej ortakeve.

Ne rast se Shoqeria nuk e ka bere te ditur vendimin e saj, brenda tre muajve nga data e njoftimit te fundit, miratimi i transferimit konsiderohet i dhene.

Ne rast se Shoqeria refuzon te jape miratimin e transferimit, ortaket, brenda tre muajve nga data e ketij refuzimi, duhet te blejne apo te lejojne blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar.

Transferimet e pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohen me nje akt noterial.

ASAMBLEA E ORTAKEVE,ADMINISTRATORI

Asamblea

Neni 10



Asambleja mblidhet me ane të lajmerimit me shkrim të ortakeve, të pakten 30 dite para datës së mbledhjes duke përdorur mjetet e komunikimit me shkrim si poste, fax, e-mail etj. Në lajmerim duhet të shkruhet vendi, dita dhe ora e mbledhjes si dhe problemet që do të trajtohen. Lajmerimi duhet të parashikojë edhe vendin dhe orën për një mbledhje të dytë nëse nuk realizohet e para. Mbledhja e dytë nuk mund të zhvillohet para se të kalojnë të pakten 24 orë nga e para.

Asambleja mund të mblidhet edhe në mungesë të këtyre formaliteteve, nëse është i përfaqësuar i gjithë kapitali shoqërisë dhe gjithashtu është prezent Organi Administrativ.

Mbledhjet e asamblese mund të zhvillohen në seline të shoqërisë, por mund të zhvillohen edhe në vende të tjera.

Asambleja e Ortakeve ka këto kompetenca :

1. Aprovon bilancin
2. Emeron Administratoren
3. Vendos ndryshimet në statut
4. Emeron ekspertet kontabel
5. Përcakton shpërblimin për Administratoren, si dhe ekspertet kontabel.
6. Vendos për çështje të tjera që i përkasin drejtimit të shoqërisë të përcaktuara nga statuti i saj dhe kërkon zbatimin nga organi i saj administrative.
7. Vendos për zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të rregjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Vendimet merren me $\frac{3}{4}$ e votave të ortakeve pjesëmarrës.

Asambleja e ortakeve duhet të mblidhet të pakten dy herë në vit.

Asambleja e ortakeve thërret mbledhjen e saj, kur Organi Administrativ e sheh të arsyeshme, ose kur kërkohet me kërkesë të motivuar nga njëri prej ortakeve, në këtë rast Organi Administrativ ka për detyrë të dërgojë lajmerimet për mbledhjen e Asamblese, brenda 30 ditëve pasuese nga kërkesa.

Kur asambleja ka pjesëmarrje të rregullta, vendimet që merren brenda kufijve të kontratës së themelimit, të statutit e të ligjeve, janë të detyrueshme për të gjithë ortakët, edhe për ata që nuk kanë diskutuar ose që nuk janë dakord.

Neni 11

Cdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër që nuk është administrator, nëpërmjet një autorizimi të thjeshtë të shkruar në fund të lajmerimit të Asamblese. Ortaku i deleguar mund të përfaqësojë në të njëjtën asamble, vetëm një ortak tjetër. Po kështu secili ortak mund të përfaqësohet në asamble nëpërmjet një personi të besueshëm të tij duke e pajisur të besuarin e tij me një prokurë speciale me anë të së cilës mund të delegojë kompetencë dhe attribute që ai gëzon si ortak në Shoqërinë e Përbashkët.

Në asamblet e ortakeve marrin pjesë nëse është e nevojshme për të dhënë mendim dhe pa të drejtë vote, (jo ortakët) si Administratori jo ortak, drejtor teknik, drejtuesit e komisioneve dhe ekspertet kontabel dhe gjithë ata që kanë detyrë të parashikuar nga Akti-Themelues, nga Statuti, ligjet dhe rregullat.

Neni 12

Asambleja drejtohet nga Administratoren e në mungesë të tij Administratori i deleguar ose dhe nga një person i caktuar nga ortaku.

Cakton Sekretarin e Asamblese i cili nuk mund të jetë ortak

Drejtuësi i mbledhjes së asamblese së ortakeve ka këto kompetenca :

-Ka fuqi te plote per te konstatuar te drejten e nderhyrjes, per te verifikuar ne se Asamblea eshte rregullisht e formuar e ne se ekziston numri i mjaftueshem per te vendosur, ai drejton diskutimet dhe vendos per menyren e votimit.

-. Ne asamblene e ortakeve dhe ne rastet kur Organi Administrativ e sheh te arsyeshme, proces-verbali i mbledhjes vertetohet nga nje noter, ndersa rregullisht neneshkruhet nga pjesemarresit ne mbledhje.

Neni 13

Kuorumi

1. Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, sipas nenit 13 te ketij statuti, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 14 te ketij statuti.

2. Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuoromit te permendur ne piken 1 te ketij neni, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

NENI 14

Marrja e vendimeve

1. Me perjashtim te rasteve kur statuti parashikon nje shumice me te larte, asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te ortakeve pjesemarres, sic percaktohet ne piken 1 te nenit 86 te ketij ligji, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

2. Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne kete ligj ose ne statut, per ceshtjet e tjera te renditura ne nenin 81 te ketij ligji, asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres.

3. Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne kete ligj, vlefshmeria e vendimeve, qe percaktojne detyrime shtese mbi ortaket, apo vendimet qe kufizojne te drejtat e tyre, te parashikuara ne kete ligj ose ne statut, kushtezohet nga miratimi i ortakut perkates.

NENI 15

E drejta e votes

1. Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne statut, cdo kuote jep te drejten e nje vote.

2. Statuti mund te parashikojte per ortaket, qe nuk jane te pranishem, mundesine e pjesemarrjes ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme me mjete te ndryshme komunikimi, perfshire mjetet elektronike, me kusht qe te garantohet identifikimi i ortakeve.

3. Mjetet elektronike perfshijne, por pa u kufizuar ne to:

a) transmetimin e mbledhjes se asamblese se pergjithshme ne kohe reale;

Neni 16

Asambleja e Shoqerise "Tregtare" **NDERTUESI NR 1**" shpk drejtohet nga Administratori i saj Zoti . **Miltiadh Baballeku, I cili zgjidhet cdo 5 vjet**



DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 17

Shoqeria Tregtare "**NDERTUESI NR 1**" shpk deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky Statut i ndryshuar dhe ato te legjislacionit shqiptar ne fuqi, vecanerisht dispozitat urdheruese e normative te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare",

Shoqeria fiton personalitet juridik qe nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit te Biznesit, si person juridik, ndersa e ushtron aktivitetin ekonomik me regjistrimin si subjekt privat ne Zyren e Tatim - Taksave.

Emertimi i Shoqerise, kapitali themeltar dhe emri i Administratorit te saj duhet te figurojne ne te gjitha aktet ose dokumentet e nxjerra prej shoqerise dhe qe u drejtohen te treteve.

Neni 18

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtjen Shoqeria Tregtare "**NDERTUESI NR 1**" shpk. Ajo ka llogari te saj ne leke dhe valute ne bankat e Shqiperise.

Neni 19

Shoqeria Tregtare "**NDERTUESI NR 1**" shpk vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper te drejta e detyrime kontraktore dhe jashtekontraktore brenda kapitalit te saj.

Ortaku i Shoqerise perballon humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tij ne kapitalin themeltar.

Neni 20

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat, me perjashtim te kompetencave qe ligji ua jep shprehimisht ortakeve. Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administratoreve edhe kur keto akte nuk perfshihen ne objektin e shoqerise. Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve, kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratoreve e kalonte objektin e Shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Neni 21

Administratori eshte pergjegjes individualisht ose solidarisht, sipas rastit ndaj Shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te Statutit te ndryshuar , apo per faje te kryera gjate administrimit te Shoqerise.

Asnje vendim i Asamblese nuk mund te ndaloje kerkese padine kunder administratorit per gabimet e kryera prej tyre gjate ushtrimit te detyres.



Neni 22

Administratori shkarkohet ose ndryshohet me vendim te ortakut te shoqerise . Ne rast se shkarkimi eshte bere pa arsye te drejte, ai le shkak per demshperblim financiar.

Pervec kesaj, administratori shkarkohet nga gjykata per shkelje te ligjit, me kerkese te cdonjerit prej ortakeve.

Neni 23

Administratorit ose ortakeve qe nuk jane persona juridike nuk u lejohet te kontraktotjne ne cfaredolloj forme qofte, te marrin hua tek Shoqeria, te japin pelqimin ne emer te saj per paradhenie, si dhe te behen dorezanes apo te garantotjne ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve. Kjo mase ndaluese zbatohet edhe ndaj perfaqsesve ligjore te ortakeve qe jane persona juridike.

Kjo mase zbatohet gjithashtu ndaj bashkeshorteve, paraardhesve dhe pasardhesve te personave te cituar ne paragrafin e pare te ketij neni, si dhe ndaj cdo personi ndermjetes.

MARRREDHENIET E PUNES

Neni 24

Marredheniet e punes ne Shoqerine Tregtare **"NDERTUESI NR 1"** shpk rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtje qe nuk rregullohen me kontrate pune zbatohen dispozitat perkatese te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Shoqeria merr persiper qe te respektoje rregullat e ligjet ne fuqi te punesimit dhe te sigurimeve shoqerore per te gjitha te punesuarit ne Shoqeri, ndersa keta te fundit jane te detyruar te pranojne kete Statut te Shoqerise.

Neni 25

Te punesuarit ne Shoqeri pergjigjen sipas ligjit dhe sipas Statutit te ndryshuar per moszbatimin e detyrave te caktuara, si dhe per demet qe ata i shkaktojne Shoqerise. Ata mbajne pergjegjesi penale dhe administrative per moszbatimin e detyrave te tyre.

Neni 26

Mosmarreveshjet e te punesuaresve me Shoqerine zgjidhen nga gjykata shqiptare. Kur pala ankuese eshte person i huaj, mosmarreveshja zgjidhet nga organi i percaktuar ne kontraten e punes.

Neni 27

Punonjesit e emeruar nuk marrin pjese ne ndarjen e fitimit qe realizon Shoqeria, gjate ushtrimit te veprimtarise se saj ekonomike, nese ne kontraten e punes nuk eshte parashikuar ndryshe.



SEKRETI I PUNES

Neni 28

Te gjithë te punesuarit ne Shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin e punes se Shoqerise. Kjo detyre vazhdon edhe mbas largimit te tyre nga Shoqeria.

Detyrimi per ruajtjen e sekretit te punes se Shoqerise eshte e vlefshme edhe per Ortakundhe Administratorin e Shoqerise.

PERFAQESIMI I SHOQERISE

Neni 29

Perfaqesimi i Shoqerise Tregtare **"NDERTUESI NR 1"** shpk i perket administratorit te saj Z. **Miltiadh Baballeku**

dhe/ose personave te autorizuar prej tij.

KONTROLLI I BRENDSHEM

Neni 30

Asambleja e ortakeve organizon kontrollin e brendshem me ekspertet kontabel te autorizuar, i cili zgjidhet cdo 5 vjet nga Administratori i Shoqerise sipas dispozitave ligjore te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare",

BILANCI DHE TE ARDHURAT

Neni 31

Viti financiar i Shoqerise mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti.

Ne mbylljen e cdo viti financiar, Administratori i Shoqerise ben inventarin dhe llogarite vjetore, ne perputhje me dispozitat ligjore mbi kontabilitetin, si dhe harton nje raport me shkrim per administrimin.

Raporti i administrimit, inventaret dhe llogarite vjetore te hartuara nga Administratori, i nenshtrohen miratimit te Asamblese se Ortakeve brenda nje afati prej 6 muajsh, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar.

Neni 32

Shoqeria nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar, pasi te jene zbritur po te jete e nevojshme humbjet e vitit te meparshem, le menjane nje shume me vlere te pakten 1/20 e tij, e cila destinohet per formimin e nje fondi rezerve te quajtur "rezerve e domosdoshme".

Neni 33

Te ardhurat neto pas shlyerjes se detyrimeve fiskale dhe atyre ndaj te treteve, ndahen midis ortakeve te Shoqerise ne perputhje me kuotat e secilit ne formimin e kapitalit themeltar te Shoqerise.

Fitimi qe do te shperndahet, perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per rezerven dhe nga ana tjeter, jane zbritur ose jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e bartura nga vitet e meparshme.

Asambleja mund te marre vendim qe te shperndahen shumat e lena menjane per rezerven qe ajo disponon. Ne kete rast vendimi tregon shprehimisht llojet e rezerves ku jane marre keto shuma.

Neni 34

Ne seline e Shoqerise mbahet dokumentacion i plote i saj, dokument themeluese te Shoqerise, si dhe dokumentet qe rregullojne marredheniet ekonomike te Shoqerise, me te gjitha ndryshimet e bera deri ne ditet e fundit.

PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Neni 35

Prishja e Shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, si ne rast falimentimi, privimim i te drejtave re te ushtuar profesionin tregtar, forca madhore dhe cdo faktor tjeter qe nuk varet nga vullneti i Ortakeve te Shoqerise., por gjithmone me vendim te mbledhjes se jashtezakonshme te Asamblese se Ortakeve te shoqerise si dhe ne baze te ligjes.

Ne keto raste Asambleja vendos mbi menyren e likuidimit te Shoqerise, duke caktuar nje ose me shume likuidatore, me pelqimin e shumices per nga kapitali te ortakeve dhe percakton detyrat e tyre.

Ne rast likuidimi te Shoqerise, emertimi i saj do te pasohet nga shenimi "Shoqeri ne likuidim e siper".

Ky shenim dhe emri i likuidusit ose i likuiduesve duhet te figurojne ne te gjitha aktet e dokumentat e nxjerra nga shoqeria dhe qe u drejtohen te treteve.

Likuidatoret dhe administratoret jane pergjegjes per veprimet e tyre dhe likuidimin e Shoqerise. Ata kujdesen per te likuiduar ne rradhe te pare detyrimet e Shoqerise ndaj te treteve.

Ndarja e kapitaleve te veta, qe mbeten pas pagimit te kreditoreve dhe te pjeseve te kapitalit themeltar, behet ndermjet ortakeve, ne perpjestim te njejte me kontributin e tyre ne kapitalin themeltar.

Ortaket thirren ne fund te procesit te likuidimit qe te vendosin per bilancin financiar perfundimtar, per aktin e rregullueshmerise per administrimin nga ana e likuiduesit dhe per heqjen e mandatit te tij si likuidues si dhe per te evidencuar mbylljen e likuidimit.

Mbasi behet njoftimi i mbylljes se likuidimit dhe kryhen formalitetet e nevojshme te likuidimit, Shoqeria c'registrohhet.



DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 36

Persa nuk eshte shprehur ne kete Statut i referohet plotesimeve nga Asambleja e Ortakeve te Shoqerise, si dhe dispozitave te legjislacionit shqiptar.

Neni 37

Cdo ndryshim e plotesim i Statutit te Shoqerise nuk prek personalitetin juridik te Shoqerise tregtare **"NDERTUESI NR 1"** shpk.

Neni 38

Ky statut i ndryshuar perpilohet ne kater kopje per:

- Qendren Kombetare te Regjistrimit ne te cilen do e depozitoje vete administratori
- Zyren e Tatim - Taksave per marrjen e lejes se ushtrimit te veprimtarise
- Dhomen e Noterise
- nje kopje mbetet si pjese e dokumentacionit te ndryshimit te bere ne Statutin e Shoqerise tregtare **"NDERTUESI NR 1"** shpk.

ORTAKE THEMELUES DHE ADMINISTRATOR I VETEM I SHOQERISE TREGTARE

" NDERTUESI NR 1 " shpk.

Miltiadh Baballeku

Miltiadh Baballeku
Firma ndertimti
NDERTUESI NR 1
BEKAT ALBANIA
Firma ndertimti

NOTERI

VIOLETA SULKAJ